

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“ART LOG” Sh. P. K

Sot, më datën 07/10/2021 Z. Artur Arapaj, i lindur në Durrës me datë 10/03/1965 madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “ART LOG” Sh. P. K si më poshtë vijon:

Neni 1

Personi fizik i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin “ART LOG” Sh. P. K

Ortak i vetëm i shoqërisë është Z. Artur Arapaj
Administrator i kësaj shoqërie caktohet Z. Artur Arapaj.
Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria “ART LOG” Sh. P. K gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Sh. P. K.”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “ART LOG” Sh. P. K është Durrës, Plazh, Lagje 13, Hyrje 2 Apartamenti 10, Zona Kadastrale 8518, Nr Pasurie 10/34/ND+2-10.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.


Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe të pa caktuar.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Konsulencë teknike
- Montim dyer dritare
- Shërbim mirëmbajtje, riparime
- Shitje - blerje artikuj të ndryshëm industrial
- Shërbime të agjensive imobiliare



Neni 5

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera teresisht nga ortaku i vetem:

Z. Artur Arapaj zoteron nje kuote me vlere 100.000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaku i vetem pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kesaj shoqerie i perket ortakut te saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKU I SHOQËRISË.

Artur Arapaj

